

Në bazë të nenit 24, pika 1.6, të Statutit të Federatës së Volejbollit të Kosovës Bordi i FVK-së në mbledhjen e mbajtur me 2 Shkurt 2023 ka vendosur të shpall:

## K O N K U R S

### **1. Sekretar të Përgjithshëm të Federatës së Volejbollit të Kosovës**

Sekretari i Përgjithshëm themelon marrëdhënie pune me FVK-në me afat të caktuar prej pesë (5) vitesh, në bazë të ligjit të punës dhe akteve tjera të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

### **Kandidati për Sekretar të Përgjithshëm duhet ti plotësoj këto kritere:**

1. Përgatitje Universitare.
2. Njohja e gjuhës angleze.
3. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
4. Përvojë pune pesë (5) vjeçare, në sportin e volejbollit.
5. Njohuri për Statutin dhe rregulloret e FVK-së dhe ligjet përkatëse të sportit në Republikën e Kosovës.
6. Të ketë aftësi organizative.

### **Sekretari kryen detyrat si në vijim:**

1. Sigurimin e ligjshmërisë së punës dhe kryerja e obligimeve të përcaktuara ligjore, administrative, financiare dhe organizative të FVK-së në mënyrë profesionale dhe sipas parimeve të kodit etik, duke përfshirë por duke mos u limituar edhe në funksionet si në vijim:
2. Përgatitjen me kohë të materialeve për mbledhjet e Kuvendit dhe mbledhjet e Bordit Ekzekutiv; Ndihmon në mbarëvajtjen e të gjitha mbledhjeve të organeve dhe komisioneve të FVK-së në cilësinë e këshillëdhënësit apo anëtarit;
3. Përgatit materialet, dokumentet dhe raportet e duhura për aplikim në procesin e kategorizimit;
4. Përgatit materialet, dokumentet dhe raportet e duhura për dorëzim ose aplikim në Departamentin të Sportit në Ministrinë përkatëse për sport me qëllim të raportimit dhe mbylljes së kisteve kuartale;
5. Përkujdeset për zbatimin e vendimeve dhe rekomandimeve të Kuvendit dhe të Bordit Ekzekutiv;
6. Ekzekutimin dhe monitorimin e planit financiar të FVK-së në bazë të kërkesave dhe vendimeve të Bordit Ekzekutiv;
7. Zbatimin e plan-programit ditor dhe planit strategjik të FVK-së;
8. Komunikimin dhe bashkëpunimin me Ministrinë përkatëse për sport, KOK, federatat tjera sportive dhe organizatat tjera ndërkombëtare sportive;
9. Sigurimin e transparencës dhe punës publike të FVK-së;
10. Monitoron publikimet e FVK-së në web-faqe, rrjetet sociale dhe media.

***Konkursi do të jetë i hapur deri me 3 Mars 2023 në ora 16:00h. Kandidatët duhet që të dorëzojnë CV-në dhe dokumentet fizikisht apo të dërgojnë në email [info@fvk-ks.org](mailto:info@fvk-ks.org).***

23.02.2023  
Prishtinë



Kryetari i FVK-së  
Bahri Gjinovci